



Npi – 01/311 datë: 27.09.2024

Duke u bazuar në nenin 12 shkronja (d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/2008); Nenin 30/A paragrafi 2 të Ligjit Nr.08/L-224 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e mbajtur më 27.09.2024, mori këtë:

## V E N D I M

### **PËR FSHIRJEN E OBLIGIMEVE TATIMORE TË AKP-së NDAJ KOMUNËS SË SHTIMES**

#### I

Kuvendi Komunës së Shtimes, në mbledhjen e -IX- të rregullt për vitin 2024, e mbajtur më: 27.09.2024, me shumicën e votave miratoi Vendimin për fshirjen e obligimeve tatimore në shumën prej 46.116.21 € të Agjencionit Kosovar të Privatizimit ndaj Komunës së Shtimes.

#### II

A r s y e t i m: Ky vendim, është miratuar pas shumë diskutimeve në Kuvend, duke u bazuar në faktin se këto obligime tatimore janë nga viti 2002, deri në privatizim dhe gjatë kësaj periudhe kohore nuk është shfrytëzuar nga Komuna e drejta sipas nenit 7 paragrafi 2.6.2 i shtojcës së Ligjit Nr.04/L034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, për ti kërkuar këto mjete nga AKP-ja si obligime tatimore të pronave të privatizuara.

Tabela e obliguesve tatimor të ndërmarrjeve shoqërore të Privatizuara ngab AKP në komunën e Shtimes.

Nr	Emri Tatimpaguesit	Adresa	Nr. Faturës	Shuma/Obligimi
1	N.SH. TREGËTIA	Shtime	1227	16,129.38
2	N.SH. KOPERATIVA BUJQËSORE	Shtime	1226	9,404.42
3	N.SH. AGROQENDRA SHTIME	Shtime	12220	6,580.78
4	N.SH. KOPERATIVA BUJQËSORE	Muzeqinë	12218	3,573.24
5	N.SH. HOTEL LYBETENI FERIZAJ	Shtime	1222	3,829.86
6	N.SH. 17 NËTORI	Shtime	1223	2,410.07
7	N.SH.K. PEMISHTE	Shtime	12222	1,706.30
8	N.SH. 17 NËTORI	Muzeqinë	12216	1,502.75
9	N.SH. PASURI BUJQËSORE	Petroviq	12213	953.66
10	N.SH. SH.A. MAGJISTRALJA	Shtime	12214	25.75
	<b>TOTALI</b>			<b>46,116.21</b>

#### III

Obligohet Zyra Tatimit në Pronë pranë Komunës së Shtimes të bëj implementimin e këtij vendimi.

#### IV

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në evidencën e protokollit zyrtar në MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb – faqen zyrtare të Komunës së Shtimes.

#### V

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë të Financave, Punës dhe Transfereve, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit  
Adnan Ademi